

KËRKESE

Drejtuar: Koordinatorit për të Drejten për Informim, Bashkia Vorë

Datë: 23 Shkurt, 2017

E nderuar znj. ANA

Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOCIP është duke asistuar bashkitë e RSH për të përmbushur sa më mirë detyrimet ligjore lidhur me njoftimin efikas të vendimarrjes së këshillave bashkiakë. Në përmbushje të objektivave që kemi marrë përsipër, ne kemi marrë kontakt paraprakisht me kryetarin e bashkisë Vore, z. Fiqiri Ismaili , i cili ka mirëpritur ftesën tonë për bashkëpunim.

Përmes kësaj kërkesë, të cilën po j'ua nisim edhe zyrtarisht me email dhe me postë, dëshirojmë të na mundësoni disponimin e serisë së plotë të vendimeve që ka marrë këshilli bashkiak Vorë, nga momenti i konstituimit të tij pas RAT e deri më sot.

Me marrjen e tyre, ne do t'i procesojmë ato me shpejtësi në platformën kombëtare, VENDIME.AL. Ju personalisht, ose IT që mund të caktojë për këtë detyrë bashkia Vorë, mund të keni më pas akses të personalizuar për të hedhur vendimet e reja që merren muaj pas muaji. Stafi i INFOCIP, mund të vazhdojë të ofrojë asistencën e tij të plotë deri në një kohë të dytë që ju e konsideroni të domosdoshme, për të garantuar publikueshmërinë e plotë të vendimeve të reja.

Me respekt

GERTI SHELLA

Drejtor Ekzekutiv

Qendra për Çështjet e Informimit Publik, INFOCIP

Address: Rr "Todi Shkurti", P. 4, Hyrja 21 Apt 34,

Tirane, ALBANIA

Mob: +355672061033

email: gshella@infocip.org

website: www.infocip.org www.vendime.al

